

KËRKESË
Nr. 4266, datë 2.9.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-Pass Vlorë (objekte)”. Subjekti kërkuar, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogarit, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “objekt”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 23 643 895 (njëzet e tre milionë e gjashtëqind e dyzetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË
SË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Eduart Seitaj

REPUBLIKA E SHQIPERISË

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

SEKTORI SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY PASS-VLORË" (shtesa)

NR	PRONARI			Z.Kad	Nr.Pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi				Vlefte ne leke	Vlefte totale ne leke	Shënime
	Emri	Atesia	Mbiemri			Sip. Ndërtimi m2	Lloji I Ndërtimit	Sipërfaqe Ndërtimi Vlefte leke/m2	Vlefte Sipërfaqe Ndërtimi			
1	SMAIL	AVNI	LALAJ	8605	6/146	120	Objekt Banimi	60120	7214400	1573302	8787702	Akt Marrëveshja ligj. Nr.8/2012 dt.09.02.2012
2	PETRI		HODAJ	1060	320	785	Objekt Biznesi		10433340		10433340	Akt Marrëveshja ligj. Nr.8/2012 dt.09.02.2013
3	BESIM		LAMAJ	2074	1019	49.6	Objekt Banimi		532131		532131	Akt Marrëveshja ligj. Nr.8/2012 dt.09.02.2014
4	BESIM		LAMAJ	2074	1019/2	81	Objekt Banimi		1377245		1377245	Akt Marrëveshja ligj. Nr.8/2012 dt.09.02.2015
5	BESIM		LAMAJ	3140	zone e pa menaxhuar	38	Objekt Biznesi		997837		997837	Akt Marrëveshja ligj. Nr.8/2012 dt.09.02.2016
6	SADETE	VEHBI	SKENDAJ	3140	zone e pa menaxhuar	58	Objekt Banimi		1515640		1515640	Akt Marrëveshja ligj. Nr.8/2012 dt.09.02.2017
	SHUMA								22070593		23643895	